



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:334774

Datë: 10.02.2025

Numri i dokumentit: 06828768

C.nr.1291/2024

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC – Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtorin profesionale Adelina Çmega, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë të paditësit P.D nga Rahoveci, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati Z.H nga Prishtina, ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria për Shëndetësi, për shkak të kompensimit të pagave të 13-ta, vlera e objektit të kontestit 1,005.00 euro, jashtë seancës, më datën 10.02.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET e tërhequr padia e paditësit P.D nga Rahoveci, në çështjen juridike kontestimore, C.nr.1291/2024.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi P.D nga Rahoveci, në këtë gjykatë përmes të autorizuarit të tij avokatit Z.H nga Prishtina, më datën 14.10.2024, ka parashtruar padinë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria e Shëndetësisë, për shkak të kompensimit të pagave të 13-ta, vlera e objektit të kontestit 1,005.00 euro.

I autorizuari i paditësit avokati Z.H, me parashtrësën e datës 28.01.2025 e ka njoftuar gjykatën se e tërheqë padinë, të paditësit P.D me numër të lëndës C.nr.1291/2024.

Prandaj, meqenëse e paditura nuk ka parashtruar përgjigje në padi, kjo gjykatë vlerëson se janë plotësuar kushtet ligjore që padia e paditësit të konstatohet e tërhequr. Kështu, në nenin 261.1 të LPK-së parashihet që *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi.”*

Vendimi mbi shpenzimet procedurale, që secila palë t’i bartë këto shpenzime, është marrë në kuptim të nenit 450 të LPK-së pasi që secila palë paraprakisht vet i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta.

Prandaj, nga ajo që u tha më lartë, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e në bazë të nenit 261.1, 261.3 dhe 261.4 të LPK-së.

Numri i lëndës: 2024:334774
Datë: 10.02.2025
Numri i dokumentit: 06828768

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.1291/2024, më datën 10.02.2025

Gjyqtari
Berkan Hamza

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.